V E N D I M
Nr. 143, datë 26.2.1998

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 549, DATË 26.8.1996 "PËR CAKTIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË ZYRAVE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME"

Në mbështetje të ligjit nr. 7581, datë 7.7.1992 "Për çmimet dhe tarifat dhe të neneve 54 dhe 56 të ligjit nr.7843, datë 13.7.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", me propozimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 549, datë 26.8.1996, lista e tarifave të shërbimit të zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme ndryshohet dhe zëvendësohet me listën që i bashkëngjitet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

NDRYSHIMI I TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË ZYRAVE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME

LLOJI I SHËRBIMEVE	ISHTE	BËHET
1. Lëshimi i certifikatave të pasurisë	200	400
2. Kërkesa për regjistrimin e pronësisë të pasurisë së paluajtshme	50	200
3. Kërkesa për regjistrimin e pjesëtimit , ndarjes ose bashkimit të pasurisë së paluajtshme	100	300
4.Kërkesa për konsultim të kartelës dhe të të dhënave të tjera të pasurisë së paluajtshme	50	200
5. Kërkesa për kontroll zyrtar të regjistrimit të pasurisë së paluajtshme	70	500
6. Kërkesa për lëshimin e kopjes së certifikatës së pasurisë së paluajtshme	300	300
7. Kërkesa për saktësimin e kufijve	500	1500
8. Kërkesa për përgatitjen e dokumenteve për në gjykatë, ose organ tjetër administrativ	250	500
9. Kërkesa për regjistrimin për kalim pronësie, qiraje, nënqiraje	150	1500
10. Kërkesa për regjistrim hipoteke ligjore	100	500
11. Kërkesa për regjistrim për fshirje hipoteke ligjore	100	500
12.Kërkesa për regjistrim për fshirjen e një vendimi gjykate a të një akti administrativ	150	500
13.Kërkesa për regjistrim servituti, marrëveshje kufizuese	200	600
14.Kërkesa për regjistrim fshirjen e një servituti, marrëveshjeje kufizuese	200	600
15. Regjistrimi i kërkesave për heqje dorë nga të drejtat pasurore mbi pasurinë e paluajtshme	150	200
16. Regjistrimi i kërkesave për fitimin e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme me trashëgimi	200	200
17. Kërkesa për regjistrimin e veprimeve juridike mbi pasuritë e paluajtshme nga personat fizikë dhe juridikë me banim jashtë shtetit	600	1500
18. Kërkesa për korrigjimin e gabimeve materiale në kartelë	100	200
19. Kërkesa për lëshim kopje kartele, harte treguese ose pjese të saj	120	400
20. Kërkesa për fotokopje të dokumenteve të pasurive të paluajtshme për çdo faqe	10	50
21. Lëshimi vërtetimit të pronësisë	-	50